



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 82/5 prot.

Tiranë, më 11.01 2019

V E N D I M

Nr. 4 Datë 11.01 2019

**”PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 22 TË DATËS 04.07.2018
TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UST-SË ”MBI MIRATIMIN E
TARIFAVE PËR APLIKIM, KONKURIM, REGJISTRIM TË FITUESVE
DHE TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR TË DY CIKLET E STUDIMEVE,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në zbatim të VKM nr. 778, dt. 26.12.2018”Për disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr.288, dt. 25.05.2018,”Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë” të ndryshuar”, VKM nr. 779 dt: 26.12.2018 ”Për disa ndryshime në VKM nr. 269, dt.29.03.2017”Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” te ndryshuar”, VKM nr. 780 dt. 26.12.2018 ”Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike” si dhe në VKM nr. 723, dt. 06.12.2018 ”Për një ndryshim në VKM nr: 288, dt: 21.05.2018,”Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në IAL Publike në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, në Vendimin e Senatit nr.5 datë 10.01. 2019, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 11.01.2019

VENDOSI:

1. Tarifa vjetore për të gjithë studentët e ciklit të parë të studimeve bachelor, sipas pikës 2, të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 22 datë 04.07.2018, paguhet në masën 50%, për vitin 2018-2019.
2. Pika 4 e Vendimit të Bordit të Administrimit nr.22 datë 04.07.2018 shfuqizohet.

3. Të shtohet në pikën 9, për të gjithë studentët e ciklit të dytë të studimeve që ju kanë mbetur kredite nga vitet akademike të mëparshme do të paguajnë vetëm tarifën për kredit të mbetur sipas vlerës së kreditit të miratuar, për vitin 2018-2019.
4. Studentët që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve dhe rezultojnë me notën mesatare të ponderuar 9(nëntë)-10(dhjetë) dhe kanë shlyer të gjithë detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit paraardhës do të përjashtohen nga tarifa e shkollimit.
5. Studentët e pranuar në vitin e parë akademik në Universitetin e Sporteve të Tiranës me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10(dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë përfshirë dhe rezultatet e maturës shtetërore, listë e cila vjen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore do të përjashtohen nga tarifa e shkollimit.
6. Studentët që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve sipas kategorive të përcaktuara në VKM nr. 780 datë 26.12.2018 do të përjashtohen 50% nga tarifa e shkollimit, të shpallen kriteret në www.ust.edu.al dhe të vendoset afati i pritjes së dokumentacionit deri në 07.02.2019, pas shqyrtimit të dokumentacionit në datë 10.02.2019 të paraqitet lista për miratim pranë Bordi i Administrimit.
7. Një kopje e listave të studentëve të përjashtuar nga tarifa e shkollimit 100% dhe 50% të përcillet në MASR.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Dega e Informacionit studentor dhe regjistrimeve, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Vladimir Gjonaj

